



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI JURIDIK

Rr. Agim Ramadani, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 229 063 • E-mail: juridiku@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Dekani
Prof. Ass. Dr. Haxhi Gashi

Nr. prot: 01/259
Datë: 10 / 06 / 2016

Në bazë të nenit, 66, 72, 76 lidhur me nenin 115 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Këshilli i Fakultetit Juridik në mbledhjen e matur me datë 19.05.2016, mori këtë:

V E N D I M

Respektim i nenit 115 të Statutit të Universitetit të Prishtinës

I

Sipas nenit 115 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, studenti ka të drejtë të riprovohet në lëndën të cilën nuk e ka dhënë gjatë vitit vijues të studimeve sipas kushteve si në vijim:

1. Studenti ka të drejtë të hyjë më së shumti tri herë në provim,
2. Studenti me një arsyetim të fortë, mund t'i lejohet nga Dekani i Fakultetit që të hyjë për të katërtën herë në provim.
3. Provimi mbahet para Komisionit prej tre anëtarësh të cilët janë emëruar nga Dekani i Fakultetit. Komisioni e pyet/vlerëson kandidatin në provim me gojë.
4. Nëse studenti nuk arrin të kalojë në provim herën e 4-të me Komisionin e përsërit vitin akademik. Në rast se studenti serish dështon 4 herë në provim gjatë vitit të përsëritur, ai humb statusin e studentit të rregullt për këtë lloj të studimeve,
5. Studenti mund të ri fitojë statusin e studentit në qoftëse paraqitet në një program të ri të studimeve sipas Statutit.

II


Obligohen Katedrat përkatëse që të propozojnë Komisionin e përhershëm në përbërje prej 3 anëtarëve. Në rast se studenti duhet të pyetet në lëndën e një anëtari të Komisionit, Komisioni plotësohet me një anëtarë tjetër. Komisionin do ta emëroj Dekani i Fakultetit, sipas propozimit të Katedrës përkatëse.

III

Vendimi zbatohet nga afati i rregullt i provimeve të Muajit Janar 2017.

Vendimi ti dërgohet:

1. Katedrave përkatëse të Fakultetit,
2. Shërbimit të studentëve të Fakultetit
3. Të shpallet në Web faqe të Fakultetit dhe
4. Arkivit të Fakultetit


DEKANI
Prof. Ass. Dr. Haxhi Gashi